LIGJ
Nr.8678, datë 14.5.2001

PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E MINISTRISË SË DREJTËSISË
(ndryshuar me ligjin nr.9112, datë 24.7.2003, nr.9694, datë 19.3.2007, nr.33/2012, datë 21.3.2012, nr. 40/2017, datë 30.3.2017)

(i përditësuar)

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti i ligjit

Ky ligj përcakton rregullat e organizimit, të funksionimit, si dhe fushat e veprimtarisë së Ministrisë të Drejtësisë.

Neni 2
Baza ligjore e organizimit dhe e funksionimit të Ministrisë se Drejtësisë
(ndryshuar me ligjin nr. 40/2017, datë 30.3.2017)

Ministria e Drejtësisë organizohet dhe funksionon në përputhje me:
a) Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;
b) ligjin për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave;
c) ligjin për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore;
ç) ligjin për nëpunësin civil;
d) ligjet e tjera të posaçme që parashikojnë rregulla lidhur me Ministrinë e Drejtësisë; dhe
dh) këtë ligj.

Neni 3
Akte nënligjore për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë

Në këtë ligj parashikohen çështjet me të rëndësishme të strukturës, organizimit dhe të funksionimit të Ministrisë së Drejtësisë, ndërsa rregullimi i hollësishëm i këtyre çështjeve përcaktohet në Rregulloren e Ministrisë së Drejtësisë dhe në urdhrat e udhëzimet e Ministrit të Drejtësisë.

Neni 4
Statusi i punonjësve të Ministrisë së Drejtësisë
(ndryshuar pika 3 me ligjin nr.9112, datë 24.7.2003 dhe ndryshuar me ligjin nr. 40/2017, datë 30.3.2017)

1. Funksionarët politikë të Ministrisë së Drejtësisë gëzojnë të drejtat dhe përmbushin detyrimet e parashikuara në ligjin për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore.

2. Nëpunësit civilë të Ministrisë së Drejtësisë gëzojnë të drejtat dhe përmbushin detyrimet e parashikuara në ligjin për nëpunësin civil.

3. Marrëdhëniet e punës për punonjësit e tjerë rregullohen nëpërmjet dispozitave të parashikuara në Kodin e Punës.

4. Magjistratët mund të komandohen në Ministrinë e Drejtësisë në përputhje me dispozitat e parashikuara në ligjin për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë. Magjistratët e komanduar gëzojnë statusin e magjistratit të parashikuar në ligjin për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.

KREU II
FUSHA E VEPRIMTARISË

Neni 5
Misioni i Ministrisë së Drejtësisë

(shtuar një fjali në pikën 1 dhe ndryshuar pika 3 me ligjin nr. 40/2017, datë 30.3.2017)

1. Ministria e Drejtësisë, në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet, ushtron funksione dhe ka në kompetencë hartimin dhe ndjekjen e politikave, përgatitjen e akteve ligjore dhe nënligjore, si dhe ushtrimin e shërbimeve të nevojshme lidhur me sistemin gjyqësor, sistemin e ekzekutimit të vendimeve penale a civile, sistemin e shërbimeve të lira juridiko-profesionale, bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën civile dhe penale, fushat e tjera të drejtësisë dhe të kompetencës së saj sipas ligjit, si dhe për bashkërendimin, harmonizimin dhe reformimin e legjislacionit shqiptar në tërësi. Bëjnë përjashtim aktet nënligjore dhe shërbimet lidhur me sistemin e drejtësisë, të cilat sipas ligjeve të posaçme janë në kompetencë të organeve të tjera të sistemit të drejtësisë.

2. Në ushtrimin e veprimtarisë së saj, Ministria e Drejtësisë ka për qëllim të kërkojë respektimin e Kushtetutës, të ligjeve, realizimin dhe mbrojtjen e dinjitetit, të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, si dhe të kontribuojë në parandalimin e shkeljeve të ligjit, në përputhje dhe në funksion të kërkesave të zhvillimit demokratik dhe të integrimit europian të Republikës së Shqipërisë.

3. Ministria e Drejtësisë ushtron kompetenca, mbështet, bashkëpunon dhe koordinon veprimtarinë e saj, sipas këtij ligji, lidhur me organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë, me institucionet e sistemit të burgjeve, të shërbimit të provës, të profesioneve të lira, me përjashtim të rasteve kur në ligje të posaçme parashikohet ndryshe.

Neni 6
Objekti i veprimtarisë së Ministrisë së Drejtësisë

(ndryshuar me ligjin nr.9112, datë 24.7.2003, shfuqizuar pika 23 me ligjin nr.33/2012, datë 21.3.2012, ndryshuar me ligjin nr. 40/2017, datë 30.3.2017)

Ministria e Drejtësisë ushtron veprimtarinë e vet në fushat:

1. Ndjek dhe përgjigjet për realizimin e politikës së përgjithshme shtetërore në fushën e drejtësisë.

2. Harton projektet e akteve ligjore e nënligjore në fushën e drejtësisë me përjashtim të akteve nënligjore që janë në kompetencë të organeve shtetërore, sipas parashikimeve të ligjeve të posaçme.

3. Jep mendim të specializuar për projektet e akteve ligjore dhe të akteve nënligjore

normative të Këshillit të Ministrave, të ministrave dhe të drejtuesve të institucioneve të tjera qendrore, si dhe për realizimin e reformimit të legjislacionit në përgjithësi.

4. Jep mendim të specializuar për përmbajtjen e projekteve të marrëveshjeve ndërkombëtare, që lidhen në emër të Republikës së Shqipërisë ose të Këshillit të Ministrave.

5. Përgatit dhe ndjek zbatimin e metodologjise së unifikuar shqiptare për procesin ligjvënës, hartimin e akteve normative dhe terminologjinë juridike.

6. Ndjek dhe realizon politikat dhe veprimtaritë, që lidhen me çështjet e përqasjes dhe të integrimit të sistemit të drejtësisë në nismat dhe strukturat ndërkombëtare përkatëse, si dhe bashkërendon punën me institucionet e tjera, në funksion të përafrimit të legjislacionit shqiptar me atë të Bashkimit Europian dhe të shteteve anëtare të tij.

7. Kujdeset për organizimin dhe funksionimin e shërbimeve, që lidhen me sistemin gjyqësor dhe atë të drejtësisë, në përgjithësi, me përjashtim të shërbimeve që janë në kompetencë të organeve shtetërore, sipas parashikimeve të ligjeve të posaçme.

8. Shfuqizuar.

9. Shfuqizuar.

10. Ministri i Drejtësisë mund të paraqesë ankesë tek Inspektori i Lartë i Drejtësisë për shkelje disiplinore të pretenduara të magjistratëve, si dhe mund të kërkojë nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë kryerjen e inspektimeve institucionale e tematike në gjykata dhe në prokurori.

Ministri i Drejtësisë i përcjell Inspektorit të Lartë të Drejtësisë kërkesën e motivuar për inspektim, vetëm pasi ka vlerësuar të gjithë informacionin e siguruar, në raport me disponimet ligjore në fuqi, që tregojnë se ka të dhëna të besueshme se magjistrati ka kryer shkelje disiplinore.

11. Shfuqizuar.

12. Drejton sistemin e paraburgimit dhe të ekzekutimit të vendimeve penale.

13. Drejton sistemin e ekzekutimit të vendimeve civile dhe të titujve ekzekutivë.

14. Drejton veprimtarinë e Qendrës së Publikimeve Zyrtare.

15. Analizon të dhënat statistikore dhe publikon vjetarin statistikor në fushën e drejtësisë. Organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë përcjellin pranë Ministrisë së Drejtësisë të dhënat statistikore të kërkuara, me qëllim botimin e vjetarit statistikor, sipas parashikimeve në ligjet e posaçme. Formati i vjetarit statistikor dhe periodiciteti i përcjelljes së informacionit miratohen me urdhër të Ministrit të Drejtësisë, pas konsultimit me organet e tjera të sistemit të drejtësisë, sipas fushës që mbulojnë.

16. Mban regjistrin e gjendjes gjyqësore dhe lëshon certifikatat në bazë të atij regjistrimi.

17. Shfuqizuar.

18. Kujdeset dhe mbështet ushtrimin, organizimin dhe funksionimin e profesionit të avokatit, noterit, arbitrit, ndërmjetësit, administratorit të falimentimit dhe të profesioneve të tjera të lira, të lidhura me sistemin e drejtësisë, sipas parashikimeve të legjislacionit të posaçëm në fuqi në fushën përkatëse.

18/1. Mbikëqyr, kontrollon, inspekton dhe bën procedim disiplinor për profesionin e noterit, përmbaruesit privat, ndërmjetësit, administratorit të falimentimit dhe të profesioneve të tjera të lira, të lidhura me sistemin e drejtësisë, sipas parashikimeve të legjislacionit të posaçëm në fushën përkatëse.

19. Shfuqizuar.

20. Mbështet realizimin e veprimtarive në fushën e drejtësisë për të miturit, për mbrojtjen e të drejtave dhe të interesave të ligjshëm të tyre, edukimin ligjor dhe parandalimin e shkeljeve të ligjit nga ana e tyre, si dhe për ushtrimin e shërbimeve ndaj të miturve, nga strukturat përkatëse të sistemit të drejtësisë, sipas parashikimeve të ligjeve të posaçme në

fushën përkatëse.

21. Drejton shërbimet e ekspertimit ligjor.

22. Kryen drejtimin metodik të shërbimeve të gjendjes civile.

23. Shfuqizuar.

24. Kryen drejtimin metodik të zyrave juridike të ministrive dhe të institucioneve të tjera qendrore.

25. Ushtron kompetencat lidhur me formimin profesional fillestar dhe vazhdues të subjekteve të parashikuara në ligjin për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë, si dhe për përgatitjen profesionale, aftësimin dhe specializimin e subjekteve të ligjeve të posaçme për profesionet e lira në fushën e drejtësisë, në përputhje me parashikimet në ligjet e posaçme.

26. Kujdeset dhe mbështet veprimtaritë shkencore në fushën e drejtësisë dhe përhapjen e edukatës juridike.

27. Kujdeset për ndjekjen dhe bashkërendimin e marrëdhënieve me shoqërinë civile për fushën e drejtësisë.

28. Ndjek bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën penale dhe civile dhe, në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare, ku shteti shqiptar është palë, realizimin e marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet kompetente të shteteve të tjera, si dhe me organizma ndërkombëtarë.

29. Kryen funksione të tjera në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare ku shteti shqiptar është palë.

30. Kryen funksione dhe veprimtari të tjera në përputhje me ligjin.

31. Strukturat përgjegjëse të mbarëvajtjes së teknologjisë i sigurojnë akses Ministrisë së Drejtësisë në nivelin “vizitor”, mbi të dhënat që gjenerohen nga sistemet respektive elektronike të teknologjisë së informacionit dhe dokumentet e prodhuara nga gjykata, që tregojnë ecurinë procedurale të çështjes, me përjashtim të të dhënave dhe dokumenteve që përmbajnë të dhëna personale të mbrojtura, informacion lidhur me të miturit, sekret shtetëror, të dhëna financiare dhe tregtare të palëve, çështje të sigurisë së palëve ose të dëshmitarëve, ose çdo të dhënë tjetër dhe informacion të mbrojtur nga ligji.

Strukturat përgjegjëse të mbarëvajtjes së teknologjisë i sigurojnë akses Ministrisë së Drejtësisë në nivelin “vizitor”, mbi të dhënat që gjenerohen nga sistemet respektive elektronike të teknologjisë së informacionit dhe dokumentet e prodhuara nga prokuroria, vetëm pas përfundimit të hetimit, që tregojnë ecurinë procedurale të çështjes, me përjashtim të dokumenteve mbi të dhënat personale të mbrojtura, të informacionit mbi të miturit, të sekretit shtetëror, të të dhënave financiare dhe tregtare të palëve, çështjeve të sigurisë lidhur me palët ose dëshmitarët dhe çdo të dhëne tjetër dhe informacioni të mbrojtur nga ligji.

32. Ministri i Drejtësisë organizon punën për mbledhjen e informacionit, me qëllim përgatitjen dhe propozimin pranë Këshillit të Ministrave, të rekomandimeve për prokurorinë, në kuadër të luftës kundër kriminalitetit. Ministri i Drejtësisë u bën të njohura rekomandimet prioritare që duhen ndjekur për vitin në vazhdim në luftën kundër kriminalitetit, drejtuesve të prokurorive të të gjitha shkallëve. Ministri i Drejtësisë ndjek në vazhdimësi mënyrën e zbatimit të rekomandimeve të dhëna prej Këshillit të Ministrave. Për këtë qëllim, Ministri i Drejtësisë kërkon jo më pak se dy herë në vit pranë Prokurorit të Përgjithshëm dhe Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme informacion mbi zbatimin e tyre. Informacioni i marrë vlerësohet nga Ministri i Drejtësisë dhe bazuar mbi gjetjet, i propozon Këshillit të Ministrave dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë marrjen e masave organizative, sipas ligjit, me qëllim përmbushjen e rekomandimeve.

KREU III
ORGANIZIMI I MINISTRISË SË DREJTËSISË

Neni 7
Funksionarët politikë

1. Ministri i Drejtësisë ka në kompetencë dhe drejton nën përgjegjësinë e tij të gjithë fushat e veprimtarisë së Ministrisë të Drejtësisë.
2. Ministri i Drejtësisë, në zbatim të kompetencave të tij, nxjerr urdhra dhe udhëzime.
3. Ministri i Drejtësisë, në ushtrimin e kompetencave të tij, ndihmohet nga zëvendësministrat.
4. Ministri i Drejtësisë, në ushtrimin e kompetencave të tij, mbështetet nga Kabineti i Ministrit.

Neni 8
Strukturat organizative në Ministrinë e Drejtësisë
(shfuqizuar titulli dhe shfuqizuar pika 5 me ligjin nr. 40/2017, datë 30.3.2017)

Në përputhje me fushat e veprimtarisë, shërbimet civile të Ministrisë së Drejtësisë ushtrohen nga:
1. Sekretari i Përgjithshëm
2. Drejtoritë e Përgjithshme
3. Drejtoritë
4. Sektorët
5. Shfuqizuar.

Neni 9
(ndryshuar me ligjin nr. 40/2017, datë 30.3.2017)

Për përmbushjen e kompetencave të veta, Ministri i Drejtësisë miraton rregulla të hollësishme për administrimin e përditshëm të veprimtarisë, funksionimin e brendshëm, përshkrimin e punës të punonjësve, rregullin dhe disiplinën në institucion.

Neni 10
(ndryshuar me ligjin nr.9112, datë 24.7.2003, nr.9694, datë 19.3.2007 dhe nr. 40/2017, datë 30.3.2017)

Struktura funksionale dhe organika e hollësishme e institucionit bëhet në përputhje me ligjin për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore.

Neni 11
Drejtoria e Përgjithshme e Çështjeve të Drejtësisë
(ndryshuar me ligjin nr.9112, datë 24.7.2003, dhe shfuqizuar me ligjin nr.9694, datë 19.3.2007)

Neni 12
Drejtoria e Bashkëpunimit Gjyqësor Ndërkombëtar
(ndryshuar me ligjin nr.9112, datë 24.7.2003 dhe shfuqizuar me ligjin nr.9694, datë 19.3.2007)

Neni 13

Drejtoria e Kontrollit Ekonomiko-Financiar

(ndryshuar me ligjin nr.9112, datë 24.7.2003 dhe shfuqizuar me ligjin nr.9694, datë 19.3.2007)

Neni 14

Drejtoria e Personelit, Organizimit dhe Shërbimeve

(shfuqizuar shkronja "ë" me ligjin nr.9112, datë 24.7.2003 dhe shfuqizuar me ligjin nr.9694, datë 19.3.2007)

Neni 15

Drejtoria Ekonomike

(ndryshuar me ligjin nr.9112, datë 24.7.2003, dhe shfuqizuar me ligjin nr.9694, datë 19.3.2007)

Neni 16

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve është institucion në varësi të Ministrisë së Drejtësisë që, sipas ligjit, ndjek e realizon organizimin dhe funksionimin e sistemit të paraburgimit, të ekzekutimit të vendimeve penale, të vuajtjes së dënimit dhe të trajtimit të të ndaluarve, të arrestuarve dhe të dënuarve me burgim.

Neni 17

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Përmbarimor

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Përmbarimor është institucion në varësi të Ministrisë së Drejtësisë që, sipas ligjit, ndjek dhe realizon organizimin dhe funksionimin e sistemit të ekzekutimit të vendimeve civile dhe të titujve ekzekutivë.

Neni 18

Qendra e Botimeve Zyrtare

(ndryshuar me ligjin nr. 40/2017, datë 30.3.2017)

Qendra e Botimeve Zyrtare është person juridik publik në varësi të Ministrisë së Drejtësisë, përgjegjëse për botimin e Fletores Zyrtare, Buletinit të Njoftimeve Zyrtare dhe për përditësimin dhe mirëfunksionimin e Arkivit Elektronik të Akteve dhe botimeve të tjera, sipas parashikimeve të ligjit për organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Botimeve Zyrtare.

Neni 18/1

Komiteti Shqiptar i Birësimeve

(shtuar me ligjin nr.9112, datë 24.7.2003)

Komiteti Shqiptar i Birësimeve është institucion në varësi të Ministrisë së Drejtësisë, i cili, sipas ligjit, ndjek dhe realizon organizimin dhe funksionimin e veprimtarive që lidhen me birësimet, për interesin e ligjshëm në mbrojtje të të drejtave të të miturve.

Neni 18/2

Shërbimi i provës

(shtuar me ligjin nr. 40/2017, datë 30.3.2017)

Shërbimi i Provës është shërbim publik, që organizohet dhe funksionon në varësi të Ministrit të Drejtësisë, në përputhje me parashikimet në legjislacionin e posaçëm.

Neni 18/3

Mjekësia ligjore

(shtuar me ligjin nr. 40/2017, datë 30.3.2017)

Instituti i Mjekësisë Ligjore është institucion qendror, buxhetor, në varësi të Ministrit të Drejtësisë, në përputhje me parashikimet në legjislacionin e posaçëm.

Neni 18/4

Arkivi Shtetëror i Sistemit Gjyqësor

(shtuar me ligjin nr. 40/2017, datë 30.3.2017)

Arkivi Shtetëror i Sistemit Gjyqësor organizohet dhe funksionon pranë Ministrisë së Drejtësisë. Mënyra e organizimit dhe funksionimit rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 18/5

Agjencia Kombëtare e Falimentimit

(shtuar me ligjin nr. 40/2017, datë 30.3.2017)

Agjencia Kombëtare e Falimentimit, si autoriteti shtetëror kompetent për mbikëqyrjen, trajnimin dhe licencimin e veprimtarisë së administratorëve, organizohet dhe funksionon pranë Ministrisë së Drejtësisë, në përputhje me parashikimet në legjislacionin e posaçëm.

KREU IV

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 19

Ligji nr.7381, datë 8.5.1990 “Për krijimin e Ministrisë së Drejtësisë”, me ndryshimet e mëvonshme dhe çdo dispozitë që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Dispozita kalimtare

(shtuar me ligjin nr. 40/2017, datë 30.3.2017)

Gjyqtarët dhe prokurorët që ushtronin funksione në nivelet drejtuese dhe ekzekutive në Ministrinë e Drejtësisë në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, konsiderohen magjistratë të komanduar dhe trajtohen sipas ligjit për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë. Ata i nënshtrohen procesit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.

Neni 20

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.3026, datë 24.5.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani.